

L I G J
Nr.8011, datë 11.10.1995

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7566, DATË 25.5.1992 “PËR ARMËT” NDRYSHUAR ME
LIGJIN NR.7809, DATË 30.3.1994**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7566, datë 25.5.1992 “Për armët”, ndryshuar me ligjin nr.7809, datë 30.3.1994, në nenin 7 shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) Punonjësit e policisë doganore, të policisë tatimore, si dhe inspektorët e Inspektoratit të Përgjithshëm Financiar në Ministrinë e Financave. Punonjësit që do të pajisen me armë zjarri dhe lloji i armatimit përcaktohen nga ministri i Financave, në bashkëpunim me ministrin e Brendshëm”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1263, datë 30.10.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha